



BASHKIA MIRDITË

Nr. 3312/1 prot

Datë: 15 .10.2024

L ë n d a : Dërgojmë “Njoftim për publikim vende të lira pune “Polic Bashkiak” në faqen Tuaj.

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Adresa : Bulevardi “B.Curri”, pranë ish – “Hotel Arbana”

T I R A N Ë

Bashkëngjitur Ju dërgojmë “Njoftim për publikim”, për t’i publikuar në faqen tuaj Website. Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 89 dt. 22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”, Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimit nr.2.datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për Vitin Buxhetor 2024.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 3912 Prot.

Rrëshen, më 15.10.2024

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR “POLIC BASHKIAK” BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 89 dt. 22.12.2022 “Për Policinë Bashkisë”, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimit nr. 452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Vendimit nr. 2.datë.08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për Vitin Buxhetor 2024”.

Bashkia Mirditë shpall vende të lira pune në pozicionin:

2 vende të lira pune në pozicionin “Polic Bashkiak” – Bashkia Mirditë

I- PËRSHKRIMI I PUNËS

- a) Përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka Policia Bashkiake sipas Ligjit nr. 89 dt. 22.12.2022 “Për Policinë Bashkisë”,
- b) Gjithë detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të Bashkisë;
- c) Gjithë detyrat që burojnë nga akte të tjera të ligjshme e që do të miratohen në vazhdimësi.

II- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë me postë apo drejtpërsëdrejti, në zyrën e protokollit pranë Bashkinë Mirditë, deri më dt. 23.10.2024 ora 15:00 dokumentet e mëposhtme

- a) Kërkesë/Letër motivimi
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopjen e kartës së identitetit
- d) Fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm/lartë dhe suplementit/listës së notave (Bachelor dhe Master)
- e) 2 (dy) Fotografi
- f) Raport aftësie për punë



- g) Çertifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti)
- h) Vërtetimin nga prokuroria
- i) Vërtetimin nga gjykata
- j) Dokument për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës
- k) Vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike
- l) Vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- m) Vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi

Mungesa e një prej dokumenteve apo pavlefshmëria e tyre, sjell mos kualifikimin e kandidatit.

III- KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidatët në procedurën e pranimi në detyrë janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar.
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- ç) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale.
- dh) Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- e) Të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit.

IV- FUSHA E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen nga komisioni për: ligjin 139/2015, “Për Vetëqeverisjen vendore”, Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, ligjin nr. 89 dt. 22.12.2022 “Për Policinë Bashkisë” dhe akte të tjera nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituara. Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhet pas njoftimit me email në datën dhe vendin e përcaktuar.

BASHKIA MIRDITË